

Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i draft aktit

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Në Ministrinë e Brendshme, më datë 16.05.2023, është zhvilluar mbledhja e pare e grupit të punës, e kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm, në zbatim të urdhrin të Ministrit të Brendshëm nr. 57, datë 28.04.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile””, të ndryshuar, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ngarkuar nga urdhri.

Më pas grupi i punës është mbledhur dhe në datë 14 qershor 2023 dhe 19 qershor 2023 për diskutimin nën për nen të ligjit nr. 10 129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, dhe u diskutua lidhur me përafrimin e legjislacionit dhe nënshkrimin elektronik

Në tetor 2023 akti ka kaluar për mendim nëpërmjet sistemit të e-akteve tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Gjithashtu, projektakti është publikuar në RENJK përgjatë periudhës 14 nëntor 2023 deri në 14 dhjetor 2023, në respektim të afateve ligjore.

Projektakti pati 607 lexime dhe 2 komente në Platformë.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile”, të ndryshuar”** janë tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.

2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 57, datë 28.04.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile””, të ndryshuar, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ngarkuar nga urdhri.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike).

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore Për Çështjet e Brendshme,
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar”, të propozohet në kuadër të reformës së	Në nenin 4, të projektligjit përcaktohet se: “Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e çdo banese që kanë në pronësi brenda ose jashtë vendit brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji duke zgjedhur ndër to edhe	Ministrisë së Drejtësisë. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.	Të reflektuara të gjitha komentet.	

<p>ndërmarrë nga Qeveria e Shqipërisë për riinxhinierimim e shërbimeve publike, ku pjesa më e madhe e tyre ofrohen “online”, në bazë të aksesit të shtetasve në portalin qeveritar unik “e-albania”.</p> <p>Me zbatimin e reformës është shtuar gama e shërbimeve “online” për qytetarët, të cilëve krahas dokumenteve me nënshkrim elektronik të prodhohen me të dhënat e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010, u mundësohet dhe përfitim i dokumenteve të tjerë që më parë lëshoheshin nga zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative dhe zyrat e arkivës së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut në sportel.</p>	<p>vendbanimin e tij”. Ndërkohë që referuar ligjit në fuqi, shtetasit kanë detyrimin të deklarojnë ato banesa që kanë për përdorim vetjak apo familjar. Lidhur me këtë përcaktim, vlerësojmë se deklarimi i adresës së çdo banese që shtetasit kanë në pronësi, tejkalon natyrën e përbërësve të gjendjes civile, e për rrjedhojë edhe fushën e përgjegjësisë së strukturave të gjendjes civile, në ndryshim nga deklarimi aktual i adresës së banesave për përdorim vetjak apo familjar, i cili lidhet me përbërës të gjendjes civile si vendbanimi dhe vendqendrimi. Për këtë arsye, në relacionin shpjegues të argumentohet se përse është parashikuar ky ndryshim.</p> <p>- Lidhur me nenin 5, të projektligjit ku përcaktohet se: “Strukturat komunitare të njësisë administrative, në juridiksionin territorial të së cilës ndodhet vendbanimi i ri, kryejnë verifikimet përkatëse, në lidhje me plotësimin e standardeve të sipërfaqes së banimit për frymë dhe vërtetësinë e deklarimeve. Në rast mosplotësimi të standardeve</p>	<p>Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.</p> <p>Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKShI)-i</p>		
--	---	---	--	--

<p>Në këtë mënyrë për shtetasit shqiptarë ofrohet një shërbim pa kosto, duke shmangur prezencën e nevojshme, kontaktin me nëpunësit e gjendjes civile në sportel, si dhe kohën fizike që më parë kërkohej për tërheqjen e dokumenteve në zyrat e gjendjes civile sipas organizimit të tyre, sipas amendimeve përkatëse.</p> <p>Propozimet ligjore sipas këtij projektligji adresojnë gjithashtu zgjidhjen e problematikave të ndeshura gjatë zbatimit të tij, referuar ceshtjes kryesore që ka të bëjë me globalizimin, ku një pjesë e konsideruarshme e shtetasve shqiptarë zhvillojnë aktivitetin e tyre jetësor jashtë vendit. Problematikat u adresohen</p>	<p>të lartpërmendura ose deklarimi të rremë, strukturat njoftojnë zyrën e gjendjes civile, e cila refuzon kërkesën me arsyetimin përkatës”, konstatojmë se verifikimet nga ana e strukturave të gjendjes civile bëhen bazuar në dy kritere, të plotësimit të standardeve të sipërfaqes së banimit për frymë dhe atë të deklarimit të rremë. Përsa i përket vërtetësisë së deklarimeve, është e paqartë se si realizohet procesi i verifikimit për konstatimin e deklarimit të rremë. Për këtë arsye kërkojmë që të riformulohet dispozita, duke parashikuar në mënyrë të qartë këtë proces.</p> <p>Lidhur me përmbushjen e standardeve të sipërfaqes së banimit për frymë dhe refuzimin e kërkesës për regjistrimin/ndryshimin e vendbanimit/vendqendrimit, kërkojmë të sqarohet se cilat janë procedurat që ndiqen nga ana e strukturave të gjendjes civile për këto raste. Sjellim në vëmendjen tuaj se plotësimi i nevojave për strehim, aq sa është një detyrim i çdo shtetasi është edhe një detyrim i organeve shtetërore. Gjithashtu, sugjerojmë që kjo pikë të riformulohet, duke saktësuar</p>			
---	---	--	--	--

<p>shtetasve shqiptarë (i referohemi këtu kategorisë së personave me qëndrim të rregullt të pajisur me leje qëndrimi, apo që gëzojnë shtetësinë e huaj), të cilët në këto vende kryejnë dhe veprime të tjera, në mbrojtje të të drejtave të tyre personale, siç është për shembull ndryshimi i përbërësve të gjendjes civile, emër, mbiemër, etj. Për të përjasur këto problematika të krijuara me qëllimin ruajtjen e njëtrajtshmërisë së identitetit të personit, lëvizjen e lirë të shtetasve është propozuar dhënia e zgjidhjes për pasqyrimin e ndryshimeve të kryera sipas ligjit të shtetit të huaj ku ata zhvillojnë aktivitetin e tyre jetësor dhe ekonomik.</p>	<p>nëse këto verifikime lidhen me dokumentacionin apo verifikimin në terren.</p> <p>- Lidhur me aksesimin e gjendjes civile elektronikisht nëpërmjet sistemit e-Albania, sugjerojmë të merret edhe mendimi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si institucioni përgjegjës për menaxhimin e sistemeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Në bazë të përgjigjes të dërguar nëpërmjet e-akteve, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është shprehur parimisht dakord për miratimin e tij brenda kompetencave të këtij institucioni, me sugjerimin për unifikimin e terminologjisë së përdorur “përfaqësi”, në “misione diplomatike dhe poste konsullore”, në përputhje me ligjin nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”</p> <p>Sugjerimi sipas pikës 1.6, referuar argumenteve të dhëna në relacionin shpjegues të projektligjit ku për regjistrimin e lindjes së fëmijës që ka lindur i vdekur është parashtruar se kryhet vetëm për efekt statistikor. Lidhur me këtë ceshtje nga</p>			
---	---	--	--	--

	Ministria e Drejtësisë është dhënë komenti se ky regjistrim nuk ka asnjë efekt tjetër, pasi në nenin 2 të Kodit Civil, zotësia juridike fillon me lindjen gjallë të personit dhe mbaron me vdekjen e tij dhe kur fëmia lind i gjallë fiton zotësi juridike që nga koha e zënies.			
RENJK, komente	Komentet të pa aksesueshme të përcjella nëpërmjet një link-u online.	Parid Turdiu Kryetar, shoqëri civile	Refuzuar	Pa akses në komentet e përcjella
RENJK, komente	Nuk me duket real. Kush ka autoritetin te nderroje adresen ne e-albania kur une si qytetare nuk kam nderruar adrese qe prej 27 vjetesh jetoj ne te njejten adrese ne e albania del nje adrese qe nuk e njoh fare.	Mimoza Koka, qytetare	Refuzuar	Komenti nuk ka të bëjë me aktin, qytetarja i referohet një problematike personale për të cilën i është kthyer përgjigje në platformë.